

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Presidenti Begaj dekreton ligjin për pagat e magjistratëve - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/presidenti-begaj-dekreton-ligjin-per-pagat-e-magjistrateve/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 08:37:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 08:33:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	98ec1af0f2dabe72ea651c1dacc0a429ebf00d260aa8476265631bfdee3e900
TEKSTI	ea9078fbf562a0fef40ec4c7613598916c99920466b1fcbac8937f7436df8ac9
PAMJA	43255824309612cad90133f1c29c9c3d30bed96947de3dd0a4755852c9192cb2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a78320c712b1e69d64d08269ec9e818e68e5ff2ba6c7870c1b43625c7eae70ad
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	35ab8d40f1b8a4415a5ce6150a0f35dfc65972e0cbe708d5f8ac326bd7570577
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a78320c712b1e69d64d08269ec9e818e68e5ff2ba6c7870c1b43625c7eae70ad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Donald Trump SHBA Bajram Begaj Poloni

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

Presidenti Begaj dekreton ligjin për pagat e magistratëve

18 Shtator 2026 | 10:33

Presidenti i Republikës nxorri sot dekreten për shpalljen e ligjit nr. 95/2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", pasi kishte dhënë më parë pëlqimin për hyrjen në fuqi të tij menjëherë.

Presidenti i Republikës dha pëlqimin për hyrjen në fuqi të ligjit menjëherë bazuar në kërkesën e Kuvendit, i cili argumentonte nevojën dhe urgjencën për hyrjen në fuqi menjëherë me faktin se shfuqizimi i dispozitave për pagat e magistratëve nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese kishte bllokuar dhënien e pagave për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, që nga data 1 gusht 2026 e në vazhdim.

Pa hyrjen në fuqi të ligjit të ri, Thesari i Shtetit nuk mund të çlirojë pagesat për magistratët.

Qëllimi i Kuvendit ishte që të mundësonte pagesat e Thesarit të Shtetit për gjyqtarët dhe prokurorët që në datën 18 shtator 2026 për pagat e bllokuara që nga data 1 gusht 2026 dhe për ato vijuese. Hyrja në fuqi e ligjit sipas procedurave të zakonshme do ta vononte këtë proces nga 15 deri në 35 ditë. Dhënia e pëlqimit nga Presidenti i Republikës për hyrjen e ligjit në fuqi menjëherë është prerogativë dhe instrument kushtetues, i cili justifikohet nga nevoja dhe urgjenca e rrethanave të rastit.

Argumentet dhe kundërgargumentet kushtetuese lidhur me masën e pagës mund të debatohen edhe në instanca të tjera kompetente, por zhblokimi në rrugë të ligjshme i vetë pagës mund të bëhet vetëm duke futur në fuqi ligjin e ri.

Hyrja e ligjit në fuqi menjëherë kërkon që Presidenti i Republikës të veprojë menjëherë.

Për Presidentin e Republikës, dhënia e pëlqimit në këtë rast i shërben mbrojtjes së një nevoje akute, me lidhje të drejtpërdrejtë me parimin e pavarësisë së gjyqësorit, që është garantimi i standardit të jetesës dhe i qëndrueshmërisë së të ardhurave për të gjithë magistratët e vendit.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

10:30 Goditet një bandë në Greqi, përdorte AI për të klonuar zërat e të afërme për të marrë para

10:20 Italia do të dërgojë anije luftarake për të mbrojtur transportin detar në ngushticën Bab al-Mandeb

10:18 OVL-UÇK sot protestë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së

SHFËRNDAJE
ARTIKULLIN

10:05 Pakistan, të paktën 16 të vrarë në përleshjet midis forcave të sigurisë dhe talebanëve

10:04 Aksident në aksin Elbasan-Peqin, plagosen një grua dhe një fëmijë (VIDEO)

09:59 Shkak sulmet ruse në Ukrainë, pezullohen fluturimet në dy aeroporte në Poloni

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI | VIDEO

Aksident në aksin Elbasan-Peqin, plagosen një grua dhe një fëmijë (VIDEO)

Një automjet është përfshirë në një aksident këtë të premte. Mjeti është përplasur me barrierat mbrojtëse në aksin rrugor Elbasan-Peqin. Sipas të dhënave paraprake, drejtuesi...

10:04 | 18/09/2026

AKTUALITET | VENDI | VIDEO

Zbulohet një lokal i përshtatur për lojëra fati dhe shitje droge, arrestohet një person në Malësinë e Madhe

Një 47-vjeçar është vënë në pranga nga policia në Malësinë e Madhe. Arrestimi i tij erdhi pasi policia zbuloi një lokal i përshtatur për lojëra...

09:17 | 18/09/2026

AKTUALITET | LAJMI KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Debatet pas mesnatës, miratohet me 84 vota ligji i maxhorancës që rrit me 2% rrogat e magjistratëve

Seanca plenare e së enjtes në Kuvend i mbylli punimet rreth orës 01:50 ku i miratuan një sërë projektligjesh ku pati diskutime dhe debate. Në...

08:45 | 18/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.